

VENDIM
Nr.891, datë 21.12.2011

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PËR
DISA TENDERA TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE,
SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, si autoritet kontraktor, deri në datën 26.12.2011, për tenderat me objektet e prokurimit, si më poshtë vijon:

a) “Përfundimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën Përroi i Agait - Qerret, loti I (fshati Golem, linjat KUZ, stacioni i pompave nr.2 deri te stacioni i pompave nr.4)”;

b) “Përfundimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën Përroi i Agait - Qerret, loti II (linjat KUZ, Përroi i Agait, stacioni i pompave nr.1 deri te stacioni i pompave nr.2)”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës - Kanalizimeve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha